



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 207, Datë 30/12/2016

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", mori në shqyrtim ankesën me numër 72, datë 21.07.2016, e paraqitur nga z. [i], kundër Mediave On-line; Anna Media Group, Jeta Osh Qef dhe Lapsi.al, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të "Identitetit gjinor, orientimit seksual dhe përkatësisë në një grup të veçantë".

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, z. [i] deklaroi se: "Më datë 13.06.2016, në Revistën Story.al, është publikuar një intervistë e ankuesit të dhënë për këtë media. Media të tjera sociale si: Anna Media, Jeta Osh Qef, Lapsi.al etj., kanë marrë këtë intervistë dhe e kanë publikuar në faqet e tyre on-line. Në momentin e publikimit të intervistës së dhënë nga ankuesi, komentet fyese, denigruese dhe diskriminuese, kanë qënë të shumta në numër. Si rezultat i gjuhës së urrejtjes së shfaqur nëpërmjet këtyre komenteve, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga ana e mediave sociale: Anna Media, Jeta Osh Qef, Lapsi.al, duke mos u marrë prej tyre asnjë hap për filtrimin e komenteve."

Përsa më lart, ankuesi ka ngritur këto pretendime pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi kërkon të merren masa që faqet e sipërcituara on-line, të fshijnë në mënyrë të menjëhershme komentet diskriminuese dhe denigruese, si dhe në të ardhmen të merren masa për filtrimin dhe ndalimin e postimit të tyre në faqet on-line, për të shmangur në këtë mënyrë diskriminimin e personave që u përkasin komunitetit LGBT.

1



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Diskriminimi për shkak të identitetit gjinor, orientimit seksual dhe përkatësisë në një grup të veçantë, janë shkaqe të mbrojtura nga ligji 10221/2010, neni 1 dhe neni 3/1, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku parashikohet se "Diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Më datë me datë 27/07/2016, ora 15⁰⁰ në mjediset e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga ana e përfaqësuesve të KMD-së, u konsultuan mediat sociale të sipërcituara, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesën Nr. 72 Rregj., datë 21.07.2016, të z. [] dhe u evidentuan Mediat sociale: *Anna Media*, *Jeta Osh Qef* dhe *Lapsi.al*, kishin ende të publikuar në faqen e tyre të ëeb-it intervistën e dhënë nga ankuesi, si dhe komentet e bëra nga ndjeksit e këtyre faqeve.

Në përfundim, si prova materiale u printuan artikujt e publikuar në *Lapsi. al*, *Jeta Osh Qef* dhe *Anna Media*, së bashku me një pjesë të komenteve të cituara në to.

2. Me anë të shkresës me nr. 735/2 Prot., datë 16.08.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, informoi Mediat On-line: *Anna Media Group*¹, *Jeta Osh Qef*² dhe *Lapsi.al*³, lidhur me ankesën bërë nga z. []

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar mediat sociale nuk parashtruan asnjë pretendim mbi ankesën e paraqitur nga ana e z. []

¹ Anna Media Group i është dërguar shkresa me Postën Shqiptare.

² Duke qënë se Media Sociale "Jeta Osh Qef" nuk kishte një adresë ku ndodheshin zyrat fizike, atëherë KMD e dërgoi shkresën bashkëngjitur në adresën e postës elektronike info@jetaoshqef.al.

³ Duke qënë se Media Sociale "Lapsi.al" nuk kishte një adresë ku ndodheshin zyrat fizike, atëherë KMD e dërgoi shkresën bashkëngjitur në adresën e postës elektronike lapsi.al@gmail.com.



Mbështetur në provat e administruara nga palët, rezultoi se:

I. Lidhur me trajtimin ndryshe dhe të pafavorshëm

Mbështetur në provat e administruara, më datë 13.06.2016, shtetas: _____ ka marrë pjesë në një eveniment të mbajtur në ditën kundër homofobisë, ku është prezantuar i veshur si femër⁴. Gjatë këtij aktiviteti ankuesi ka dhënë një intervistë për Median e shkruar Story.al, në të cilën citon faktin e të qenit transeksualja e parë në muzikën shqiptare. Intervista e dhënë për Revistën "Story", është publikuar edhe në media të tjera sociale (si p.sh.: Anna Mesia, Jeta Osh Qef, Lapsi.al etj.). Në momentin e publikimit të intervistës së dhënë nga ana e ankuesit, ndjekës të faqes kanë komentuar intervistën duke publikuar të dhënat e sakta që lidhen me identitetin e ankuesit, si dhe duke e ofenduar dhe shprehur komente diskriminuese, në formën e shqetësimit ndaj tij.

Sipas informacionit të administruar gjatë procesit të hetimit dhe provave bashkëngjitur ankesës, u konstatua që:

- Në faqen në Facebook të, *Anna Media Group*, konstatohet se pas publikimit në këtë faqe, referuar artikullit të shkruar në Revistën Story, me titull "*Transi shqiptar: Ditën mashkull, ndërsa natën femër!*", janë dhënë rreth 30 komente nga ndjekës të faqes, duke publikuar të dhënat e sakta që lidhen me identitetin e ankuesit, duke e ofenduar dhe shprehur komente fyese ndaj ankuesit.
- Në faqen në Facebook të *Jeta Osh Qef*, konstatohet se pas publikimit në këtë faqe, referuar artikullit të shkruar në Revistën Story me titull, "*Rrëfehet këngëtarja e parë transeksuale në Shqipëri: Ditën jam djalë, natën bëhem femër.*", janë dhënë rreth 118 komente nga ndjekës të faqes, duke publikuar të dhënat e sakta që lidhen me identitetin e ankuesit, duke e ofenduar dhe shprehur komente fyese ndaj ankuesit.
- Në faqen eeb të *Lapsi.al*, konstatohet se pas publikimit në këtë faqe, të artikullit të shkruar në Revistën Story, me titull "*Transi shqiptar: Ditën mashkull, ndërsa natën femër sepse dua të bëhem këngëtare*", është dhënë 1 koment, duke publikuar të dhënat e sakta që lidhen me identitetin e ankuesit.
- Përsa i përket pretendimeve të ngritura nga ankuesi, lidhur me faqen *Instagënjim*, në rrjetin social *Instagram*, nuk u gjend asnjë e dhënë për faqen *Instagënjim* dhe rezultoi që kjo faqe nuk ekzistonte.

⁴ Referuar intervistës së dhënë në Median Revista Story, të dhënë nga ankuesi më datë 13.06.2016.

Gjatë periudhës së trajtimit të ankesës nga ana e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mediat sociale të sipërcituara, nuk kanë marrë asnjë masë për filtrimin apo seleksionimin e komenteve të shfaqura në intervistën e dhënë nga ana e shtetasit. Edhe më datë 10.10.2016, pas një konsultimi me faqet e mediave sociale: Anna Media, jeta Osh Qef dhe Lapsi.al, intervista vijonte të ishte e shoqëruar me komentet që kanë shprehur ndjeksit e faqeve që në momentin e publikimit të intervistës.

Në komentet që kanë shoqëruar intervistën e dhënë nga ana e ankuesit, komentuesit e intervistës kanë shfaqur të dhëna mbi identitetin e vërtetë të ankuesit, si dhe kanë shprehur komente fyese dhe denigruese ndaj tij.

II- Lidhur me trajtimin në mënyrë të diferencuar për shkakun e pretenduar nga ankuesi, Komisioneri gjykon se:

Përsa i përket shkaqeve të pretenduara, bazuar në informacionin e administruar nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton që ankuesi nëpërmjet intervistës së dhënë në Revistën Story, ka bërë publik faktin që i përket komunitetit LGBT. Pra, shkqet e pretenduara nga ankuesi janë të mbështetura në fakte dhe prova.

Neni 1 i Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", përcakton se "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër". Pra siç shihet personat për shkak të orientimit seksual gëzojnë mbrojtje nga sjelljet diskriminuese apo që e nxisin atë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese e cila garantohet nga neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të cenohet dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve.

Praktika e vendosur nga këto media, përmes publikimit të një informacioni në faqet e tyre online, për persona apo grupe personash që i përkasin një komuniteti të caktuar, dhe liria e publikimit të komenteve me përmbajtje nga më të ndryshmet, mund të kontribuojë në vendosjen e qëndrimeve negative, agresive dhe diskriminuese për të gjithë individët apo komunitetet në Shqipëri.

Ligji 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në nenin 3 citon: "*Diskriminim i tërthortë*" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë".

Në pikën 1/b, të nenit 17 të Ligjit Nr. 10 128, datë 11.05.2009 "Për Tregtinë Elektronike", parashikohet që: "*Kur një shërbim i shoqërisë së informacionit konsiston në ruajtjen e informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesën e marrësit të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit:*

a)

b) *me marrjen e këtij informacioni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacion.*"

Duke iu referuar çështjes Delfi AS kundër Estonisë, vërejmë se GJEDNJ parashtroi se: "*...duhet të mbahet përgjegjësi, në parim, për gjuhë shpifëse ose të llojeve të tjera të paligjshme dhe kjo të përbëjë mjet efektiv ndaj cenimit të personalitetit të individëve. Për më tepër, Gjykata vërejtë që, në rastin në fjalë, komentet e kontestuara përbënin gjuhë të urrejtjes dhe nxitje të drejtpërdrejtë për dhunë, që portali i lajmeve i kompanisë kërkuese ishte një nga mediat më të mëdha të internetit në vend dhe që kishte pasur shqetësim publik në lidhje me natyrën kontradiktore të komenteve që ai tërhoqte. Pavarësisht nga mekanizma të caktuara të ngritura nga faqja e internetit e kompanisë kërkuese për të trajtuar komentet që përbënin gjuhë urrejtjeje ose gjuhë që nxit dhunë, të cilat mund të funksiononin në shumë raste si mjet i përshtatshëm për ekuilibrimin e të drejtave dhe interesave të të gjitha palëve të përfshira, ato kishin qenë të pamjaftueshme në rrethanat e veçanta të rastit konkret, meqenëse komentet e paligjshme kishin qëndruar online për gjashtë javë".*

Mediat sociale ndaj të cilave z. ... a paraqitur ankesë edhe pas marrjes dijeni nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nëpërmjet shkresës Nr. 735/2 Prot., datë 16.08.2016, se ankuesi ndër të tjera, ka kërkuar të merren masa që faqet e sipërcituara on-line, të fshijnë në mënyrë të menjëhershme komentet diskriminuese dhe denigruese, por nuk kanë marrë asnjë masë për filtrimin e këtyre komenteve. Mosfiltrimi i komenteve ka lejuar që të publikohen të dhënat personale pa konsensusin e ankuesit.

Paligjshmëria e veprimeve dhe fakti që mediat: Anna Media Group, Jeta Osh Qef dhe Lapsi.al, nuk kanë marrë asnjë masë për filtrimin apo ndalimin dhe përhapjen e komenteve të cilat denigrojnë dhe trajtojnë në mënyrë fyese ankuesin, në mënyrë të tërthortë kanë vënë në pozita diskriminuese ankuesin, z. ...

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosmarrja e masave apo veprimeve nga ana e mediave sociale të sipërcituara, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e ankuesit në kushte të disfavorshme, duke krijuar kështu një mjedis frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues.

Mediat e mësipërme nuk kanë ofruar asnjë informacion apo pretendim në përgjigje të shkresës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1⁵, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se Z. ... është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Mediave sociale: Anna Media Group, Jeta Osh Qef dhe Lapsi.al, trajtim i cili ka lidhje të tërthortë, me *Identitetin gjinor, orientimin seksual dhe përkatësisë në një grup të veçantë të ankuesit*.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁵ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të Identitetit gjinor, orientimit seksual dhe përkatësisë në një grup të veçantë, të Z. [Emri i personit] nga ana e mediave soaciale: Anna Media Group, Jeta Osh Qef dhe Lapsi.al.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e administratorëve të mediave të sipërcituara, për filtrimin dhe ndalimin e postimit të tyre në faqet e tyre on-line, të komenteve diskriminuese ndaj ankuesit dhe personave që u përkasin komunitetit LGBT.
3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa nga ana e administratorëve të mediave të sipërcituara, që në të ardhmen të filtrohen dhe të ndalohet postimi i komenteve diskriminuese ndaj personave që u përkasin komunitetit LGBT apo çdo personi tjetër.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Administratorët e mediave on-line: Anna Media Group, Jeta Osh Qef dhe Lapsi.al, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

